

Të nderuar kolegë,

Me hyrjen në fuqi të VKM mbi "PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË PROGRAMIT TË ÇERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË" Ju bëjmë me dije se:

- Cikli i ri i riçertifikimit do të përfshijë **farmacistët dhe ndihmësfarmacistët**
- Ky cikël i riçertifikimit do të zgjasi 4 vjet, brenda të cilit Ju duhet të përfitoni 60 kredite.
- Numri minimal i krediteve të domosdoshme brenda një viti është 5 kredite.
- Secili farmacist apo ndihmësfarmacist duhet që me shume se 50 % të krediteve ti përfitoj nga aktivitetet e zhvilluara brenda specialitetit
- Me anë të edukimi në distancë nuk mund të përfitohen më shumë se 50 % të krediteve.
- Me anë të vetëraportimit të literaturës së lexuar nuk mund të përfitojnë më tepër se 20 % të krediteve.
- Raportimi i krediteve duhet të bëhet brenda vitit gjatë të cilit janë ndjekur, pranë QKEV.

Nga detyrimi për të përmbushur numrin e krediteve përjashtohen për këtë cikël:

- Ata profesionistë, të cilët dalin në pension brenda periudhës 4-vjeçare të ciklit dhe që **nuk do të vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e tyre në sektorin privat.**
- Profesionistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit ndërpresin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë
- Profesionistët që punojnë në administratë

Për informacion më të detajuar Ju lutem drejtoheni Vendimit të Këshillit të Ministrave, datë 22 shtator 2015.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!